



e Rahovecit

Komuna e Rahovecit përuroi projektin “Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë së Kulturës” në Celinë

Rindërtimi dhe riorganizimi i objektit, nga një objekt pothuajse jofunksional, përfshin: riparimin e brendshëm, termoizolimën e brendshëm e të jashtëm, riparimin e çatisë, ndërrimin e dritareve, ndriçimin, sallën prej 425 m² me kapacitet 170 ulëse dhe punë të tjera, është financuar nga Komuna e Rahovecit dhe kap vlerën: 29,299.00€.



U themelua zyrtarisht Muzeu i Masakrës në Krushë të Madhe

Në mbledhjen e Kuvendit, në praninë profesorëve të Universitetit të Prishtinës, u shqyrtua dhe u miratua njëzëri propozim-vendimi për themelimin e Muzeut të Masakrës në Krushë të Madhe. Profesorët dhe studentët e universitetit morën mirënjohje me motivacionin: “për kontributin vullnetar (nëntor 2023 - mars 2024) në konceptimin, dizajnimin dhe përgatitjen e ekspozitës muzeale të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.



Rikthehen shërbimet postare në Krushë të Madhe

Komuna e Rahovecit, bashkë me zyrtarë përgjegjës nga Posta e Kosovës - Rajoni i Prizrenit, nënshkruan memorandum bashkëpunimi për shfrytëzimin e hapësirës komunale në Krushë të Madhe. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është në interes të ofrimit të shërbimeve postare për qytetarët e kësaj zone.

OJQ-të që veprojnë në Komunën e Rahovecit përfitojnë më shumë mjete financiare nga buxheti i Komunës së Rahoveci

Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Afrim Dina, bashkë me kryetarin Latifi, nënshkruan kontratat me OJQ-të përfituese të subvencioneve nga fushat e kulturës, të rinisë dhe të sportit.

Përfituese nga thirrja e DKRS-së janë 29 OJQ nga 31 sa kanë aplikuar. Vlera e përgjithshme e përkrahjes financiare për këtë vit është: 189.400€, apo 17% më shumë se në vitin 2023.



Inaugurohet vendosja e dy pritave të mbeturinave në lumin “Drini i Bardhë”

Në kuadër të shënimit të 22 Prillit, nën moton "Natyra pa Plastikë", Komuna e Rahovecit, bashkë me partnerët nga organizata "Pamkos", inauguruan vendosjen e dy pritave të mbeturinave në lumin “Drini i Bardhë”.

Pritat e mbeturinave janë vendosur me qëllim të parandalimit të ndotjes në lumin Drini i Bardhë, në dy zona të Komunës së Rahovecit, në Fortesë dhe në Ratkoc. Këto prita, përveç mbledhjes, do të mundësojnë edhe matjen e sasive të mbeturinave që barten nga këta dy lumenj.



Bëhet përrurimi i dy parqeve në Opterushë dhe në Retijë të Poshtme

Kryetari Latifi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, zëvendësministrin e MAPL-së, z. Avdulah Djesevic dhe banorët e fshatrave Opterushë dhe Retijë e Poshtme, bënë përrurimin e parqeve në këto dy fshatra, të cilat janë bashkëfinancim i Komunës së Rahovecit (84959€) dhe MAPL-së (50000€). Kontrata përfshin edhe kolektorët për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec.

Këto parqe do të jenë në shërbim të banorëve të këtyre fshatrave, ku fëmijët dhe grupmosha të ndryshme do të kenë mundësinë të zhvillojnë aktivitete dhe të kalojnë kohë më shumë së bashku.

